


PROCESVERBALI

Nr. i prot. 3375 Më 28.12.2018
-III- Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 27.11.2018 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Kryesuesi – Përshëndetje për nënkyretarin e komunës z. Fatmir Iska, për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprvimi i Draft - Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi Kërkesës së Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, (Hiqet nga rendi i ditës)
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, (Hiqet nga Rendi i ditës)
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik dhe kthimit të pronave nga NBI “Rahoveci”, OP “OLT” Bërnjakë, NSH “Podrima”, Ndërmarrja Komunale “ZHDRELO”, Ndërmarrja Transportuese “Kosova Trans”, Ndërmarrja Shoqërore “18 Nëntori”, Koperativa Bujqësore “Bashkimi”, Organizata themelore e koperuesve, në emër të Komunës,
8. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen e stacionit të autobusëve në komunën e Rahovecit.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë para se ta qes në aprovim rendin e ditës, kemi një kërkesë nga propozuesi i pikës së 6 dhe 7, i cili kërkon nga ne që pika e 6 dhe 7 të hiqen nga pikat e rendit të ditës. Ftoj z. Isak Hoti të na jepe një sqarim sa i përket pikës së 7 të rendit të ditës.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kryetari i komunë dhe zyra ligjore me datë 20.11.2018, ka pranuar një shkresë nga MAPL, komuna e republikës së Kosovës nuk guxojnë të marrin asnjë veprim për

kthim të pronave nga AKP-ja në pronësi të komunës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Po ju citoj një pjesë të kësaj shkrese: Pavarësisht veprimeve procedurale të ndërmarrë deri më tani, duke marr parasysh kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me qartësimin ligjor për kalimin e pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës në shfrytëzim të komunave adresuar gjykatës kushtetuese, ju njoftoj se deri në vendimin përfundimtar të kësaj gjykate nuk do të ndërmerr asnjë veprim ligjor dhe procedural. Kjo është arsyja pse ne kërkojmë që pika e 7 të hiqet nga rendi i ditës.

Afrim Oriuçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, propozoj anëtarëve të kuvendit të komunës që ta heqin pikën e 6 nga rendi i ditës, arsyetimi është se ne kemi filluar që të bëjmë një regjistër me të gjitha pronat të cilat do ti japim me qira dhe e njëjtë parcelë na del që figuron se kuvendi i komunës më parë ka marrë një vendim për këtë pronë, por nuk është dalë në ankand publik.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë i qes në votim propozimet që pika e 6 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime janë aprovuar propozimet që pika e 6 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës. Tani të nderuar e qes në votim rendi e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Kryesuesi – A ka ndonjëri nga drejtorët që nuk ju është përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar, nëse ka atëherë mundeni të dilni që të ju përgjigjeni pyetjeve të parashtruara nga kuvendarët, sipas zyrtarit të zyrës së kuvendit disa drejtor përgjigjet kuvendarëve ju kanë përcjellë me anë të emalit. Fjalën e keni ju kuvendarë që të parashtroni pyetje ekzekutivit.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të parashtroj një pyetje rreth ndërtimit të rrugës Krushë e Madhe – Qëndresë, kam pasur bisedime me disa banorë të Krushës së Madhe, ata kanë vërejtje sepse rruga nuk ka filluar të ndërtohet nga fillimi i rrugës kryesore në drejtim të Krushës së Vogël që shkon, por ndërtimi i kësaj rruge ka filluar në mes. Dhe për shkak të peshave të rënda që kalojnë në këtë rrugë ka ardhur deri tek pëlcitja e mureve të shtëpive. Pyetje ime është pse nuk ka filluar nga fillimi kjo rrugë, po ashtu kjo rrugë a do të kryhet siç ka qenë e planifikuar apo do të ketë ndonjë lëvizje.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pas një vizite në fshatin Sopniq e vizitova shkollën filliore ku u takova me drejtorin e kësaj shkolle z. Xhafer Gashi, ku së bashku me të biseduam rreth çështjes së kësaj shkolle. Të nderuar kjo shkollë nuk kishte nxehje qendrore, kurse i ka 27 radiator dhe kaldajën, por këtu mungon instalimi i rrjetit të nxehjes qendrore. Pyetje ime për drejtorin e DKA-së është ku qëndron problemi që tek kjo shkollë nuk funksionon nxehja qendrore. Pyetja e dytë ka të bëjë rreth një ankesë drejtuar kuvendit komunal përmes meje nga z. Qëndrim Hoti, për qeshjet e parregullsisë në drejtorin e DKA-së, mos hapja e konkurseve, pastaj pranimi i mësimdhënësve të cilët kanë kryer shkollat në fakultetet privat, po ju citoj ankesën: Po ju drejtoj këtë ankesë tek ju për arsyen se janë duke u bërë shkelje ligjore në mos hapje të konkurseve të lira pune, dhe mos hapje të konkurseve për arsimtarë të cilat i kanë kryer fakultetet në kolegje private dhe janë ende duke punuar si në fshatrat: Dejnë, Vrajak, Bratotin, Drenoc, Senoc dhe Pastasel. Kemi mbi 45 mësimdhënës që janë të punësuar në drejtime të ndryshme me kolegje private. Kurse unë Qëndrim Hoti i kam përfunduar studimet në universitetin e Prishtinës Bachelor 4 vjeçar dhe 2 vite master në drejtimin e edukimit fizik dhe sportit. Ne fare nuk kemi përparësi kundër atyre që e kanë kryer në kolegje private dhe kjo bie në kundërshtim me ligjin e arsimit neni 16.5. në fshatin Senoc një mësimdhënës i lëndës së historisë është duke dhënë lëndën e edukatës fizike, kjo është e papranueshme në institucionë arsimore, ka edhe shumë padrejtësi të tjera që janë duke u bërë nga kjo drejtori, por herrave të tjera do i ceki me emra. Mos hapja e konkurseve në fshatin Kramovik sipas disa burimeve që i kam, kjo

shkollë me kohë e ka bërë kërkesën në DKA për hapje të konkursit në këtë shkollë për lëndën edukatës fizike, por kërkesa e kësaj shkolle nuk është marrë deri më tanë parasysh nga drejtori i DKA-së z. Avni Morina, sikurse të ishte pronë e tij private. Kërkoi nga kuvendi komunal që të merren masa rrëth kësaj parregullsie në arsim në Komunën e Rahovecit, nuk është rasti i vetëm i Qëndrimit po ka edhe shumë raste të tjera, por për momentin nuk do i përmend.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në mbledhjen e kaluar e kam ngritur një çështje e cila ka të bëjë me renovimin e një objekti të banimit kolektiv në qytet, ky objekt gjendet përball Teqesë së Madhe. E kam cekur se gjatë renovimit të këtij objekti kulmi nuk është rinovuar në tërësi, por vetëm pjesa që është e mbuluar me llamarinë, kurse pjesa e terasës nuk është rinovuar, drejtoi i Shërbimeve Publike është përgjigjur duke thënë se është bërë renovimi në këtë ndërtësë. Por pyetje ime ka qenë a ka qenë i gjithë kulmi në projektin për renovimin e objektit, ne dimë se ky projekt ka qenë i qeverisjes së kaluar, por banorët duan të dinë pse është bërë renovimi i gjysmës së kulmit e jo i gjithi. Pyetje e dytë shkon për Drejtorinë e Shëndetësisë, ka të bëjë me AMF-në në fshatin Brestoc, ka gati një vit që kjo ambulancë është mbyllur. Banorët e fshatrave Brestoc dhe Hoçë e Vogël duan ta dinë pse është mbyllur kjo ambulancë, nëse rihapsit kjo ambulancë do të bëhet edhe shkarkimi i QKMF-së në Rahovec, ne kemi një frekuentim shumë të madhe të pacienteve në QKMF për arsyet e mos funksionimit të këtyre AQMF-ve. I bashkëngjitëm kërkesës së banorëve të këtyre dy fshatrave që kjo AMF të rihapsit sa më shpejtë.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një propozim dhe besoj se do të më përkrahin edhe kolegët e mijë, nesër është festë dhe kolegu ynë z. Astrit Thaçi ka nderuar jetë dhe nuk është më në mesin tonë, propozimi imë është që familjes së tij të i ndahet një mirënjohje Post – Mortum.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ju shpreh një shqetësim nga banorët e fshatit Guri i Kuq, DKA-ja ka bërë një thirrje publike për kompanitë e ndryshme të cilët mundën të ofertojnë dhe të ofrojnë shërbim për bartjen e nxënësve nga Guri i Kuq deri në Kramovik. Është kontraktuar një kompani e cila e bënë bartjen e nxënësve 2 herë në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje, nxënësit që i dërgon në mëngjes në mesditë kur e kryen shkollën duhet që të udhëtojnë në këmbë, po ashtu edhe nxënësit e mbas ditës deri në fshatin Kramovik duhet që të shkojnë në këmbë e pastaj të kthen me transportin që ju është ofruar nga komuna. Me këtë marrëveshje dhe këtë kontratë pse nuk është paraparë bartja tre herë në ditë, pra edhe në mesditë të kenë transport, mendoj se është dashur me këtë çmim të përfshihet transporti 3 herë në ditë.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të ndaj me ju një shqetësim të lagjes së anadrinit dhe lagjeve përreth saj nga fshati Ratkoc, tash e një kohë banorët e këtyre lagjeve janë pa ndriçim publik, shtyllat të cilat janë të vendosura që një kohë nuk janë duke funksionuar, fatkeqësisht gjatë stinës së dimrit kur nata bie më herët shumë fëmijë rrezikohen kur të kthehen nga shkolla, pasi siç e dimë të gjithë problemin me qentë endacak. Lusë drejtorinë përkatëse që të ketë parasysh këtë gjendje dhe të ndërmerr sa ma shpejtë që është e mundur masa.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua ta ngrisë një çështje në lidhje me kontratat e ka lidhë komuna e Rahovecit lidhur me furnizimet me material teknik për institucione publike, konkretisht për shkollat. Disa artikuj kontraktuesi i vendos disa çmime të lira, në momentin kur drejtorët e shkollave bëjnë kërkesa për ato artikuj, ata nuk furnizohen fare. Paramëndoni kontraktuesi e ka vendosur çmimin për një kolic dore 0.10 cent, ky artikull nuk i sillet shkollave, arsyaja e tyre është se duhet të bëhen porosi më shumë nga arktikut e tjerë në mënyrë që të kompensohen këto artikuj. Kisha kërkuar në ekzekutivi që të ndërmerr masa ndaj operatorit dhe të i kërkohet ose të i furnizoj shkolla sipas kërkesave të tyre ose në të kundërtën të i shkëputet kontrata.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sot kam ardhur me një propozim për kryetarin e komunës, por pasi ai nuk qenka prezent sot në mbledhje uroj që të ja përcillni këtë propozim. Meqë tanë jemi në prag të festave të fund vitit dhe siç e do rendi tanë bëhet edhe zbukurimi i qytetit, ndahan mjete nga komuna për këtë aktivitet, propozimi imë është që këto mjete të destinohen për një qellim tjetër, pra të i ndahen familjeve në nevojë. E dimë që kushtet tona ekonomike janë shumë të këqija, prandaj mendoj se me

këto mjete ne mundemi të i ndajmë disa familjeve në nevojë si pako ushqimore, veshmbathje etj. Të i grumbullojmë mjete nga asambleje, të bashkëpunojmë me njerëz të vullnetit të mirë, mendoj se kjo kishte me qenë më e rëndësishme se sa të zbulurohet qyteti për një javë dhe në fund asgjë tjetër.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Rasim Fazliu, nëse do të ishte nisur rruga nga Randobrava për Krushe të Madhe atëherë ndoshta nuk do të kishte pasur nevojë të bëhet transporti i rëndë nëpër rrugë lokale në Krushe, dhe këtë do ta ndërtonte Prizreni e jo Rahoveci, fati mirë është që ka filluar ndërtimi i rrugës nga Krusha e Madhe për Randobrav, ne jemi detyruar që nga fillimi i Krushës ta ndërtojmë rrugën. Jam në dijeni për krije të një muri, kam kërkuar zyrtarisht të më vije një kërkësë dhe pastaj të formohet një komision dhe të shikojmë se a është krisur muri i shtëpisë nga qarkullimi i peshave të rënda apo nga diçka tjetër, besoj se shumë shpejtë do të zgjidhet ky problem.

Rasim Fazliu – I nderuar drejtor pikërisht e thashë, meqenëse është nisur nga Krusha e Madhe në drejtim të Randobraves, por pyetja ime ishte pse nuk është nisur nga rruga kryesore të Krushës së Madhe.

Përparim Krasniqi – I nderuari z. Rasim në atë pjesë ka probleme pronësore, ne kemi problem pastaj sepse jemi duke hyrë në procedura të shpronësimit dhe komuna nuk ka kapacitet që ti përballoj të gjitha këto çështje, prandaj ne e kemi zgjedhur problemin e pronave publike. Por besoj se vitin e ardhshëm do të ndërtojmë edhe atë segment, sepse nuk është shumë segment i gjatë diku rreth 300 m. Kurse sa i përket renovimit të ndërtesës së banimit, i nderuari z. Fehmi Cena jam interesuar për këtë projekt, ky projekt është në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, i kam angazhuar inxhinierët pasi një reshje që e kemi pasur kohët e fundit. Është e vërtet që komuna ka investuar në vitin 2017 në këtë ndërtesë, por ky projekt është ende i papërfunduar, i kam autorizuar që të i bëjnë thirrje kompanisë e cila e ka fituar këtë projekt dhe besoj se ky problem do të zgjidhet për arsy se kompania nëse nuk e ka kryer punën atëherë duhet ta kryej ose me dëshirë ose detyrimisht në mënyrë që të zgjidhet ky problem. E nderuara Hanalora Hoti ne kemi qenë dy herë me kompaninë e kontraktuar për ndriçim publikë, do të bëhet revidimi i atij ndriçimi për arsy se janë disa poqa të vjetër dhe ne duhet që ti vendosim të reja, atë ditë e kam ftuar kuvendarin Ali Morina dhe Kryetarin e Fshatit Ratkoc, ku kemi dalë dhe i kemi bërë matjet dhe besoj se pas ndalimit të reshjeve do të fillojnë punimet rreth ndriçimit. E nderuara Besmire Bytyqi ne nuk mundemi të dallohem nga komunat e tjera ne duhet të kemi një dekorim të qytetit sadopak i vogël të jetë, por po ju njoftoj zyrtarisht se për herë të parë komuna e Rahovecit ka bërë ftesë publike për qytetarët OJQ-të, bizneset dhe gjithë ata që donë të marrin pjesë në dekorim të qytetit, ne jemi duke u takuar me të gjitha palët, pra komuna duhet të ndaj disa mjete për dekorim, por jo aq sa e bëjnë komunat e tjera.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Fehmi Cena besojmë se në muajin dhjetor do ta funksionalizojmë AMF-në Brestoc, ftoj doktorin që në cilësinë zëvendësdrejtorit të QKMF-së që të jep kontribut në këshillin drejtues të QKMF-së.

Fehmi Cena – Drejtori i DSHPS-së nuk ka qenë në mbledhjen e kaluar sepse ne e kemi qartësuar që pozita e zëvendësdrejtorit të QKMF-së nuk ekziston, ekziston pozita e kryeshefit të QKMF-së. Përndryshe dihet detyra ime si mjek dhe si kryeshef, jam për atë që të bëhet një plan sa më i mirë për një ekip shëndetësore që do të punojë në AMF në Brestoc. Ekuuptoj gjithashtu sepse Rahoveci ka mungesë të mjekëve, por megjithatë duhet një përpjekje më e madhe, nuk është e thënë që mjeku aty të punojë gjithë javën, por të jetë 2-3 ditë në javë, kurse infermierë kemi mjaftë që janë punësuar përmes Caritasit, mendoj se këtu duhet një angazhim më i madh edhe i drejtorit të DSHPS-së dhe drejtorit të QKMF-së.

Nënkyetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Faton Ramadani shqetësimi i juaj është me vend sa i përket furnizimit me material teknik, nuk është vetëm ky rast ka edhe shumë raste të tjera, ne këtë shqetësim do e adresojmë aty ku duhet. Kurse sa i përket pyetjes së z. Masar Popaj sa i përket ankesës së z. Qendrim Hoti, i nderuar sa i përket hapjes së konkurseve për atë vendos DKA-ja se a duhet të hapet një konkurs apo jo, po ashtu nuk mundemi me paragjyku se nëse hapet një konkurse ankuesi i cili e ka bërë këtë ankesë duhet të pranohet patjetër, për këtë vendos komisioni i cili bënë vlerësimin e kandidatëve. Kurse sa i

përket pyetjeve të tjera që i keni parashtruar sot, nëse nuk kanë përgjigje sot drejtorët, besoj se në mbledhjen e ardhshme do të ju përgjigjen.

Faton Ramadani – I nderuari nënkyetar e kam një replikë sa i përket diskutimit tuaj, ju e thatë se drejtori i DKA-së është ai i cili vlerëson se kush duhet të pranohet e kush jo, dhe a dihet të hapet një konkurs apo jo, konkretisht tek personi në fjalë ka qenë konkursi i hapur, por atij ju është bërë padrejtësi, personi në fjalë është me titull magjistër i edukatës fizike. Edhe unë mendoj se është komisioni ai i cili vlerëson se kush duhet të pranohet e kush jo, por është duke ju bërë e padrejtë disave kandidatëve, dhe ne nuk duhet të e lejojmë që kandidatëve tanë të ju bëhet kësot padrejtësi. Kandidatët të cilët mendojnë se ju është bërë e padrejtë bëjnë ankesa në organet përgjegjëse dhe pastaj DKA-ja gjobitet me shuma deri në 3,500.00 €, kjo nuk është mirë të ndodhë.

Nënkyetari – I nderuari z. Faton Ramadani nuk e thash që drejtori i DKA-së bënë vlerësimin, por e thash se DKA-ja e bënë vlerësimin për hapje të një konkursi, kurse sa i përket vlerësimeve është komisioni i cili është caktuar nga ana e DKA-së ai i cili bënë vlerësimin, ne nuk mundemi me paragjyku se cili kandidat do të pranohet.

Afërdita Thaqi – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkesa ime ka të bëjë me fshatin Çifllak sa i përket ndriçimit publik, ndriçimi publik është bërë në disa fshatra të komunës sonë, kurse në fshatin Çifllak, Dobodol dhe Dejnë ende nuk ka filluar. Në këto vende ku keni filluar ndriçimin publik a kanë qenë ato fshatra më të rëndësishëm për ju, sepse asgjë nuk flitet për këto fshatra që i ceka më parë, po ashtu edhe aty ku janë bërë sikurse tek rruga e UÇK-së në Rahovec, kemi informata se nga kjo rrugë janë marrë poqët dhe janë dërguar në fshatin Xërxë, nuk e di sa është e vërtet kjo mundet të jetë edhe dezinformatë. Por pyetja ime konkrete është se kur do të bëhet ndriçimi publik për tre fshatra që i ceka më parë.

Ali Zhuniqi – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem me ankesën të cilën e lexoi z. Masar Popaj, nënkyetari me shumë modesti dhe komoditet e dha përgjigjen, por i nderuar nënkyetar nuk është bash ashtu gjendja siç jeni duke e paraqitur ju, ne i dimë presionet që vinë nga kryetari dhe personat gjegjës tek komisionet të cilat bëjnë vlerësimin për pranimin e një kandidati. Që nga marrja e qeverisjes nga kryetari janë ndërruar shumë drejtor, edhe në pozitat gjegjëse qofshin ato edhe më të larta si drejtori ose shkolla fillore ose të mesme, të gjitha këto pozita bëhen me urdhër të kryetarit të komunës.

Vjosa Isma – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, konkursi në shkollën e mesme “Xhelal Hajda - Toni”, një mësimdhënësi i lëndës së fizikës ka dalë nga vendi i punës për një vit apo më shumë nuk e di, por konkursi për këtë lëndë nuk është shpallur as i brendshëm por as i jashtëm, por janë marrë mësimdhënës nga shkolla fillore dhe ju janë dhënë orë në shkollë të mesme, pa kualifikim për të dhënë mësim në shkollën e mesme. Drejtori i DKA-së është duke punuar sikurse të jetë në shtëpi të vetë, kur donë e shpallë një konkurs kur donë nuk e shpallë, pra qysh i tekët atij ai vepron.

Nënkyetari – I nderuari z. Ali Zhuniqi unë flas me komoditet çdo herë dhe nuk flasë kur me emocione ose nervozizëm, nuk dua të lidhem me paragjykimet e juaja, ajo është vetëm një paragjykim që ti je duke e thënë. A duhet të kem emocione kur të i përgjigj z. Masar Popaj, jam duke treguar një realitet i cili është, prapë po e them është DKA-ja ajo e cila vlerëson se a duhet të hapet një konkurs. Çdokush mundet të bëjë ankesë për hapje të një konkursi është e drejtë e secilit, por sa qëndron kjo ankesë duhet të vlerësohet.

Kryesuesi – Të nderuar e qes në votim propozimin e znj. Florije Boshnjaku që familjes së kolegut tonë z. Astrit Thaqi, i cili ka ndërtuar jetë dhe nuk gjendet në mesin tonë të i ndajmë një mirënjojhe Post – Mortum: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i znj. Florije Boshnjaku. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrimi dhe aprvimi i Draft - Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019.

Afrim Limani – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, në bazë të ligjit Nr.06 L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, sipas këtij ligji për çdo vit rregullorja e tatimit në pronë duhet të kalojë përmes kuvendit, për të vërtetuar se a ka nevojë që të bëhet rregullimi i koeficienteve sepse shkallët tatimore janë të njëjta. Edhe në këtë vit ne si Drejtori e Financave në Rregulloren për tatim në pronën e paluajtshme nuk kemi paraparë

që të bëjmë ndryshime sepse kjo rregullore është e njëjta nga viti i kaluar, ne të gjithë e dimë se nivelet e vlerave dhe e koeficientet në komunën tonë janë më të ulëta në Kosovë. Karakteristik e kësaj rregullore është se për herë të parë fillon së aplikuari edhe tatimi në parcela – tokë, ju njoftoj se tatimi në parcela përfshinë: Parcela në shtëpi familjare të cilat janë të ndara në zona prej 1-6, pastaj i kemi njësitë komerciale të parcelave ku janë të ndara në 6 zona, ku përfshihen: Parcelat në objekte komerciale, parcelat për rekreacion komercial dhe parcelë për transport komercial. Gjithashtu kemi edhe njësitë industriale të parcelave, ku përfshihen katër zonat: parcelë për industri, parcelë për impiant elektrik dhe gropë zhavorri. Pastaj i kemi njësitë e parcelave bujqësore të cilat janë të ndarë në pesë zona: Arë, kulloso, livadhe, pemishte dhe vreshta. Dhe në fund janë njësitë pyjore të parcelave ku përfshihen në 4 zona, në parcelë pyjore dhe parcela pyjore malore. Përshkrimi i zonave që është bërë në rregullore ka të bëjë kryesish me tatimin në pronë ku ka ngelë e pandryshueshme, kurse përcaktimi i zonave, shkallëve tatimore dhe koeficienteve të zonave të parcelave është përcaktuar nga departamenti i tatimit në pronë i MF.

Florije Boshnjaku – Këtë propozim Rregullore e kemi shqyrtuar edhe në KPF ku i kemi marrë disa sqarime, por unë së bashku me kolegët e mijë sot besoj se do i kërkojmë edhe disa sqarime shtesë për arsyen se për herë të parë po fillon të zbatohet tatimi mbi parcela. Ajo që nuk e kam unë të qartë është te njësitë rezidenciale të parcelave, parcelat për shtëpi familjare, janë të ndara në gjashtë zona, zona e parë është 55 €, pastaj nga zona e dytë fillon të zbritet 40 €, zona e tretë 20 €, zona e katërt 12 €, kurse zona e pestë është 35 €, zona e gjashtë 15 €, dua ta di arsyen pse në zonën e pestë është bërë ngritja e taksës, po ashtu edhe zona e gjashtë është më e lartë se zona e katërt. Pastaj tek njësitë komerciale të parcelave, zona tatimore: Parcelat për objekte komerciale përsëri është zona e parë 100 €, dyta 75 €, treta 65, katërt 36 €, pesta 55 €, po ashtu edhe tek njësia industriale e parcela është njësoj. Tek njësitë e objekteve bujqësore zona e parë e kemi 5 €, dyta 1.5 €, treta 3 €, katërt 2.20 €, zona e pestë prapë rritje 3.20 €, ku është arsyaja e kësaj rritje në zonën e peste, sa e di unë parcelat janë të ndara deri në 7 klasë, pyetja ime është a do të ndahen parcelat me klasë apo me zona. Tek njësia pyjore e parcelave e kemi :Zona e parë 1.5 €, dyta 1 €, treta 0.80 €, kurse zona e katërt prapë shkon duke u ngritur në 1.20 €. Tek objektet bujqësore zonat tatimore: Zona e parë 95 €, dyta 70 € e kështu me radhë kurse zona e pestë është prapë 95 €. Drejtor a janë bërë gabime teknike apo si qëndron puna,, kishte me qenë mirë të na jepni një sqarim sepse me të vërtet nuk e kam të qartë. Po ashtu edhe tek kjo tabelë nuk e kam të qartë ku shkruan hudhër peshqesh. I nderuari drejtor objektet i kemi të ndarë me zona, a do të paguhet tatimi në pronë në bazë parcelave si klasë e par deri tek i shtata apo në bazë të zonave.

Masar Popaj – I nderuari drejtor tek shkalla e amortizimit drejtori e ceku më duket 10 mijë nëse e kam kuptuar mirë, por desha të këshillohem me ju në lidhje me njësitë e parcelave bujqësore, duke u bazuar në kalkulimin timë ku 1 hektar i bije 10000 m^2 , do e marrë një shembull për zonën e parë: $10000 \text{ m}^2 \times 5 = 50000 \times 0.16\% = 80.00 \text{ €}$, nuk e di a e kam llogaritur mirë. Por pyetja ime është ne si anëtar të kuvendit a kemi të drejtë dhe a mundemi të ndikojmë në ndryshim të koeficientit.

Rasim Fazliu – E kam përcjellë me vëmendje dhe është shumë mirë që është duke u zbatuar për herë të parë tatim në toka në nivel të Republikës së Kosovës, kjo është mirë edhe për komunën sepse i sjellë të ardhura më shumë për mirëqenie më të mirë të qytetarëve. Ajo që është e mira e krejt kësaj është se drejtori në ka thënë se në vitin e parë qytetarët do e paguajnë vetëm 20 % të vlerës së caktuar, pastaj të dytin 40% e kështu me radhë, pra tek pas vitit të katërt fillon pagesa 100%. Pyetja ime është rreth tabelës së faqes së fundit tek norma tatimore ose koeficienti, këto norma ose koeficiente a janë fiksë apo janë të ndryshueshme, aq më tepër kur në faqen e parafundit neni 4 ceket norma tatimore në zbatim të ligjit 06/L-005 ceket: Për tatimin në pronën e paluajtshme neni 9 paragrafi 1 dhe nën paragrafët 1.1 deri në 1.9, kuvendi komunal i komunës së Rahovecit cakton norma tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, në përgjashtim të kategorisë që është pronë publike. Meqenëse kuvendi komunal është ai i cili i cakton këto koeficient, pyetje ime është a kemi mundësi ne që ti propozojmë vlerat jashtë kësaj që ju i keni caktuar. Tek norma tatimore e njësive bujqësore të parcelave, ajo që më intereson është nën paragrafët 1.1 ceket: Për

njësitë bujqësore të parcelave normat tatimore munden të variojnë në shkallët prej 0.15% – 0.5%, kurse ne këtu e kemi të cekur normën tatimore 0.16%, pyetje ime është a jemi brenda ligjit o apo kemi dalë jashtë tij. Po ashtu kam edhe një pyetje për drejtorin, p.sh një truall është me sipërfaqe 5 ari kurse objekti i ndërtuar në këtë truall e ka zënë hapësirën vetëm 1 ari, në pjesën ku është objekti i ndërtuar ajo parcelë prej 1 ari a do të tatimohet apo do të mbetet me tatimin e shtëpisë, apo do të paguhet edhe tatimi për shtëpi edhe për tokë.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoi një sqarim nga drejtori rrëth ndarjes së zonave, nuk e kam të qartë se në sa zona ndahet qyteti i Rahovecit, këtu është një përshkrim shumë i shkurtër ku ceken vetëm disa rrugë që i takojnë kategorisë së zonës së parë, kurse ne nuk e dimë se rrugët e tjerë dhe lagjet e tjera në cilat zona janë të përfshirë. Propozoj që të bëhet një sqarim sa më i madh dhe sa më i qartë në mënyrë që kuvendi të vendos për të gjitha zonat dhe për të gjitha rrugët, dhe në këtë mënyrë nuk do i lihet hapësirë zyrtarëve komunal që të nxjerrin vendime ad –hoc, dhe ata të cekin se cila shtëpi i takon cilës zonë. Po ashtu nuk jam duke parë edhe sqarimin se baza e tatimit a bëhet me m^2 apo për shtëpi banimi, nëse është për shtëpi banimi atëherë është shumë gabim, sepse kemi objekte me madhësi të ndryshme dhe nuk është e drejtë që të tatimohen të gjithë njëjtë.

Qazim Qeska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të doja nga drejtori që të na shpjegojë më gjerësisht nocionin parcelë për shtëpi, fjalia parcelë e ka kuptimin e gjer, por në kuptimin e tatimimit parcela për shtëpi, deri më tani janë tatimuar vetëm objektet duke filluar nga përdheses, etazhet, katet etj. Po ashtu kërkoi edhe një sqarim në pyetjen e kolegut z. Rasim Fazliu, a kemi ne si kuvend autonomi për të lëvizur propozimin që e keni dhënë ju,, apo është normë imperativë e cila nuk na lejon që të lëvizim tek normat, ngase neni 9 e cekë se kemi të drejtë.

Fehmi Cena – Në KPF janë dhënë disa sqarime, i kemi kuptuar disa gjëra, por po ashtu është mirë që edhe tani janë duke u bërë disa pyetje dhe me këtë ne do ta kemi më shumë të qartë, sepse kemi të bëjmë me një rregulllore e cila ka disa gjëra shtesë në krahasim me rregulloren e kaluar e kjo është tatimi mbi toka bujqësore dhe parcela. Ne në KPF e kemi shprehur një shqetësim sepse është duke u shtuar një takës për qytetorët tanë, pastaj mos është duke u bërë diçka e shtrenjtë dhe mos jemi duke i ngarkuar qytetarët me këtë taks, drejtori na është përgjigjur në bazë të një formule ku e ka cekur se është një pagesë simbolike, dhe nëse është ashtu ne pajtohemi sepse kjo e ka dobinë e vetë, do i nxisë qytetarët tanë që të punojnë tokën e papunuar. Sa e kuptova unë sot drejtorin do të tatimohet vetëm metrazhi që është shtëpia, por pyetje ime është çka do të bëhet me oborrin e shtëpisë a do të tatimohet edha ai. Pastaj tek toka kemi tokë bujqësore të punuar dhe të papunuar, këtu dua një sqarim a do të tatimohet vetëm toka e papunuar apo të gjitha tokat. Këto janë ato që do kisha dashur të mi sqaroj drejtori së bashku ,me të gjitha ato që i thanë kolegët t mijë parafolës, posaçërisht tek zonat.

Afrim Limani – E kuptoj kureshtjen e juaj, po ashtu e di që jeni konfuz në disa raste sidomos tek përcaktimi i zonave. Caktimin e zonave e ka bërë Ministria e Financave departamenti i tatimit në pronë për një punë të kamotshme në bazë të analizave dhe vlerësimeve, shënimë ka marrë nga drejtoria e kadastrës, shënimë ka marr nga shitblerja e pronës dhe pasurisë dhe në fund kanë ardhur tek një përcaktim i zonave. Është një hartë zonale unë e kam parë, kam dashur edhe juve të ju prezantonj në kuvend që ta keni më të qartë, por në atë hartë nuk kishte përshkime të vendbanimeve por ishte vetëm hartë malore dhe nuk kemi mundur të vijmë me një përfundim të saktë dhe kjo ka qenë arsyaja pse nuk e kam sjellë. Arsyja pse e kanë bërë klasifikimin në kaq shumë zonë është sepse p.sh tek toka sa më shumë të ketë zona aq më mirë do të jetë për qytetarin, sepse nëse një çmim prej 5 € për m^2 e klasit të parë dojë të ndryshojmë me një tokë të klasit të pestë, këto zona ndryshojnë sipas pozicionit gjeografik, sepse ndryshtë është një tokë e cila është buzë drinit dhe ndryshtë është një tokë e cila gjendet në pjesët kodrinore. Sa i përket llogaritjes gjithmonë m^2 shumëzohet me çmim, pe marr një shembull për parcelë për objekte komerciale m^2 shumëzohet me 100, rezultati është 0.15 dhe në fund dele një vlerë e caktuar që realisht nuk është e lartë. Çmimi i tarifës së zonave sigurt është përcaktuar sipas kualitetit të tokës, vlerës së tokës, rëndësisë së tokës, pozitës gjeografike etj. I nderuari z. Masar Popaj pyeti rrëth shkallës së amortizimit, sipas një kalkulimi që e kemi

bërë sa është përcaktuar vlera e një toke, shkalla e amortizimit në fillim e thash se sipas ligjit gjithmonë llogaritet një lloj amortizimi vjetor, dhe ai amortizim ka qenë gjithmonë minus 10,000.00 € në bazë të llogaritjes apo shumëzimit të m^2 me vlerë dhe në fund dele rezultati. Mirëpo këtë vite departamenti i tatimit në pronë pranë MF këtë lloj amortizimi e ka ritë në 15,000.00 €, dhe në bazë të këtij amortizimi komuna e Rahovecit ka humbje në tatimin për pronë në bazë të llogaritjeve tona që i kemi bërë diku rrëth 90,000.00 €. P.sh nëse e marrim një shembull për tatimin në objekte, e marrim një shtëpi me $200\text{ m}^2 \times 220\text{ €} = 44,000.00\text{ €}$ - $15,000.00\text{ €} \times$ koeficienti na del rezultati diku rrëth 46.40 €. Tek tatimi i parcelave i kam mare disa shembuj nëse e marrim një arë me 10000 m^2 e shumëzojmë me tarifën e zonës së parë na dele diku rrëth 80.00 €, për kullosa është 54.00 €, livadhe 64.00 €, pemishte 80.00 €, vreshta 80.00 €. Por ligji i tatimit në pronë e ka paraparë që deri në vitin e katërt kjo vlerë prej 80.000 € tatohet në vlerën deri në 20%, pastaj prej vitit të pestë fillon të tatohet vlera reale. Po ashtu i nderuari z. Rasim Fazliu ju si kuvendar keni të drejtë të jepni kontribut për të ndryshuar koeficientin, por ne si Drejtori e Financave nuk kemi shkuar deri tek kufiri më i ulët por kemi shkuar deri tek 0.16 % sepse edhe kjo nuk është duke ndikuar shumë në rritjen e vlerës.

Rasim Fazliu – Drejtor këtu ceket nga 0.15 % - 0.5 %, kurse ne kemi shkuar në 0.16%, pra ne kemi dalë jashtë kësaj kornize, pyetje ime është e thjeshtë a kemi të drejtë ta kemi këtë tarifë. Pastaj tek zona këtu në materialin që na keni servuar i kemi 4 zona, por ajo që dua unë të them është se në zonën e 4 po ceket se në këtë zonë përfshihen të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit të cilat nuk janë të përfshirë në zonat e cekura më lartë, respektivisht vendbanimet malore, e këto janë: Zatriq, Kaznik, Guri i Kuq dhe Mrasori. Pyetje ime është ku po mbetet zona e pestë në bazë të kësaj që e lexova. Po ashtu pajtohem 100% me znj. Florije kur e ceku se zona e parë duhet të jetë më e shtrenjtë e pastaj të tjerat duhet të janë më të lira, pra e fundit duhet të jetë më e lira, për këtë arsyje janë përcaktuar zonat.

Afrim Limani – E thash në fillim se katër zona janë vetëm për tatimin në objekte, ne i kemi të përshkruara në këtë rregullore, ato katër zona që janë të përshkruara me përkufizime se nga ku ja fillojnë dhe ku përfundojnë janë vetëm për tatimin e objekteve, nuk ndërlidhen me zonat e parcelave. Kurse zonat tjera që janë për tatimin në parcela janë diku 6 zona diku 5 zona krejt varet nga rëndësia, ne ndoshta kemi harruar që të shkruajmë edhe një zero sepse kufiri më i ulët është 0.15 %, kurse më i larti është 0.50 %, pra ne kemi të drejtë që ta ndryshojmë këtë koeficiente nga 0.15 % deri në 0.50 %, tanë kontributi i juaj është tanë pikërisht këtu. Ne si drejtori e financave kemi menduar që mos të shkojmë tek kufiri më i ulët prandaj e kemi cekur 0.16 % edhe ashtu nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Z. Munib Durguti baza e tatimit bëhet në bazë të m^2 , doktori pyeti a tatojen të gjitha objektet, po i nderuar të gjitha tatojen sipas sipërfaqes të m^2 herë çmimi.

Kryesuesi – E qes në votim Draft - Rregulloren për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit ë ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi Kërkесës së Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit.

Bjondina Kleqka – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, na ka ardhur një kërkesë nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, për emërtimin e disa institucioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit, besoj se të gjithë e keni para vete listën me emrat e propozuar. Palestra e sportit në Rahovec me emrin e dëshmorit Mizahir Isma, stadiumi i futbollit në Rahovec me emrin e dëshmorit Jahja Danuza, qendra e kulturës Krushë e Madhe me emrin e dëshmorit Muhamed Malsori, qendra e kulturës në Ratkoc me emrin e dëshmorit Jahë Hoti, qendra e kulturës Drenoc Fehim Gashi dhe qendra e kulturës Xérxë Shkelzen Krasniqi. Të bashkangjitur në propozim i gjeni edhe nënshkrimet e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, pasi që komisioni për vlerësimin e institucioneve komunale ka përfunduar, stojmë kuvendarë t që ti përkrahin këto propozime për arsyje se e kemi obligim moral.

Munib Durguti – sa i përket kësaj pike unë do flas vetëm për propozimin e parë për Mizahir Isma, me siguri edhe kolegët e tjerë do të ndërlidhen me propozimet e tjera. Jam dëshmitar i rastit që para lufte dëshmori i kombit në fjalë ka qenë shumë aktiv dhe shumë i lidhur me fushën e sportit ne së bashku kemi qenë aty, i vetmi aktivitet dhe si të rijnë ka qenë që të mblidhemi pasdite që të luajmë futboll dhe basket. Sa

e di Mizahiri ka qenë edhe anëtar i klubit të basketballit, prandaj mendoj se është propozim me vend ngase rininë e tije e ka lidhë shumë me aktivitete sportive, për këtë dëshmoj unë dhe shumë shokët e mijë që së bashku me Mizahirin kemi luajtur në kohën e para lufte.

Refki Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem rreth pikës së katërt të rendit të ditës, jemi mbledhur që të emërtojmë vende me vlera të jashtëzakonshme, vende ku dom të zhvillohen ngjarjet të ndryshme, vendi ynë ka shumë njerëz me vlera dhe që padyshim do e meritonin që çdo institucion të mbante emrin e tyre. Sa i përket qendrës së kulturës në fshatin Xërxe, në emër të qytetarëve të fshatit Xërxe do ju propozoj një emër të një artisti, një njeri që e dashuronte artin e muzikës. Këto ditë ne humbëm një njeri i cili nuk e mori pushkën të luftonte, por arma e tije ka qenë violina. Qetësin dhe harren që e ofronte Behar Kryeziu me mjeshtërinë e një violinisti nuk mundet të harroj asnjëri që i dëgjoi ato tinguj., me lejon i që të ju flasë pak për biografinë e Behar Kryeziut: Behar Kryeziu u lind në fshatin Xërxe të Komunës së Rahovecit me 20.04.1960, në moshën fëmijërore e humbi të pamorit falë një sëmundje të cilën nuk arriti ta mundte edhe pas shumë përpjekjeve në spitalin e Gjakovës, Prishtinës dhe të Beogradit, shpresa që të sodit botën përmes syve mori fund. Kështu që deri në vdekje i mbeti që krijimet dhe gjërat e bukura të i vëzhgoj me sytë e zemrës. Qysh në moshën fëmijërore u dallua me talentin e tij në këndim dhe ekzekutim të violinës, gjatë shkollimit të tij në shkollën filllore në Prizren dhe Mitrovicë dhe të mesmen speciale në telefoni në Republikën e Kroacisë u dallua në interpretimin solistik në këndim dhe në violinë. Pas përfundimit të shkollës u punësua në Feronikël dhe Silos, Behari ka qenë anëtar i rregullit i shoqatës kulturo artistike “Ganimete Terbeshi”, gjithashtu ishte edhe pjesëtar i shoqatës kulturo artistike “Arshikët e Xërxe”. Ishte fitues i disa festivalave ku u shpërblye me çmime, një person si Behar Kryeziu me violinën dhe zérin e tij nuk mundë të mungonte në dasma dhe ahengje familjare. Behari nderoi jetë me 20 nëntor 2018, pas vete la bashkëshorten, 3 vajza dhe 2 djem. Kolegë të nderuar ne nuk jemi kundër që institucionet e tona të emërohen me emrat e dëshmorëve, por Behar Kryeziu do e meritonte që të nderonim në këtë mënyrë, një njeri që nuk e pa violinën e tije si dukej, por e ndjente që harku i saj ishte gjithçka që i duhej të krijonte tingujt që haptazi tregonin talentin e tij. Po e ritheksoj edhe një herë që propozimi i banorëve të fshatit Xërxe është që shtëpia e kulturës në Xërxe të emërohet me emrin e Behar Kryeziut, kurse sheshi i cili gjendet në mes të fshatit të emërohet me emrin e dëshmorit Shkëlzen Krasniqi. Ju ftoj të tregoni mirëkuptim dhe të përkrahni këtë propozim, ju faleminderit.

Florije Boshnjaku – Të nderuar kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtaur në KPF, kishte me qenë mirë që pasi janë prezant këtu përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta të dalin dhe të na japid një arsyetim për emrat e propozuar që na kanë ardhur në kuvend. Ne jemi pro këtyre propozimeve që na kanë ardhur nga shoqatat e dala nga lufta, pajtohem me propozimin e z. Refki Kryeziu, por ne duhet të kemi të qartë sepse edhe unë nga fshati kërkesë më ka ardhur një kërkesë që shtëpia e kulturës të fortës ët merë emrin e Fatos Zhuniqi, i cili është vrarë në kohë lufte dhe ai është mare me aktivitete kulturore. Prandaj ne është mirë që të konsultohemi me shoqatat e dala nga lufta dhe ata të dalin dhe të arsyetojnë propozimin e tyre dhe të na tregojnë se emërtimet e institucioneve do i bëjmë me emrat e dëshmorëve apo do të dalim jashtë kësaj.

Vajdin Berisha – Kryetar i Shoqatave të dala nga Lufta – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shoqatat e dala nga lufta kuvendit komunal ja kanë drejtuar një kërkesë për emërtim të disa institucioneve kulturore dhe sportive, propozimet tona janë këto: Palestra e sportit në Rahovec me emrin e dëshmorit Mizahir Isma, arsyeva pse e kemi bërë këtë propozim është si e tha edhe kuvendari z. Munib Durguti sepse është mare me sport, është njeri i cili ka punuar në ilegalitet, ka qenë pjesëmarrës aktiv i luftës çlirimtare të Kosovës, rrënja e tij është njëra nga rrënjet më heroike që ka ndodhur në Kosovë së bashku me shokët e tije tek maja e Shkodranit. Stadiumi i futbollit në Rahovec me emrin e dëshmorit Jahja Danuza, po ashtu edhe ky është mare me sport ka qen lojtar aktiv i ekipeve të Rahovecit në futboll, ka rënë dëshmor në shish mal të Boges, nuk e di se çka duhet më tepër të i shtojmë. Qendra e kulturës Krushë e Madhe me emrin e dëshmorit Muhamed Malsori, Muhamdi ka rënë dëshmor me 04.12.1998 në Pashtrik , ka qenë udhëheqës i shoqërisë kulturo artistike në Krushe të Madhe, prandaj besoj se është një propozim shumë me vend. Qendra e

kulturës në Ratkoc me emrin e dëshmorit Jahë Hoti, i cili ka rënë dëshmorë po ashtu në Pashtrik me 1993, në atë kohë kur ne ende nuk ja kishim filluar luftën, ai ka rënë dëshmorë duke bartur armatim për përgatitje të luftës. Qendra kulturore në Drenoc Fehim Gashi, intelektual ku k pasur botime shkencore edhe në shtetin Gjerman dhe besoj se kësaj shtëpie të kulturës i shkon shumë emri i tij. Dhe qendra e kulturës në Xërxe Shkelzen Krasniqi, arsyeva pse e kemi bërë këtë propozim është sepse ai ka qenë luftëtar i dy luftërave, Shkelzeni në vitin 2000 ka rënë dëshmor në Preshev. Respekt për Behar Kryeziun e kam njohur edhe personalisht, por të gjitha këto propozime nga ana e organizatave të dala nga lufta janë bërë në kohën kur Behar Kryeziu ka qenë gjallë. Ne si shoqatë ju kemi sjellë kërkesën dhe ju si kuvend jeni ata që vendosni për këto emra.

Fehmi Cena – Kur jemi tek kjo pikë e rendit të ditës e cila është shumë me rëndësi, ne këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe për këto emra të propozuar nga shoqatat e dala nga lufta nuk kemi qenë kundër askush, të gjithë anëtarët e KPF-së i kemi përkrahur këto emra, sepse këto emra janë shumë të njohur dhe kontribuues të mëdhenj për këtë ditë ku jemi ne sot, ata edhe jetën e tyre e kanë dhënë për vendin, popullin, pra për këtë ditë që ne sot jemi duke e gëzuar. Ne edhe atë ditë kur e kemi diskutuar këtë pikë e kemi thënë që ka qenë më mirë sikurse të ishte bërë një debat pak më i gjerë me banorët lokal të atij vendi ku është institucion, sepse është në pyetje emërtimi i institacioneve të rëndësisë publike. Natyrisht se këto institucione e kanë rendësin e gjithë komunës e jo vetëm të një lokaliteti, por ka qenë mirë që të mirët parasysh ky diskutim, pyetja ime ka qenë e është bërë ndonjë debat me qytetar, pra a janë njoftuar qytetarët rrëth këtyre emërtimeve. Nga kjo pyetje e kam marr një përgjigje përgjysmë dhe e kemi pasur dilemën që ndoshta do të ketë më vonë dilema edhe tek qytetarët, ose ndonjë konfuzitet, dhe ja tani ku jemi para një të tillë, pra është duke na dalë një propozim nga një lokalitet ku e kemi një institucion. Mendoj sikurse të ishte një njoftim pak më i gjërë ne sot nuk do të kishim këtë situatë dhe shumë më lehtë do të kishim me marrë këtë vendim. Njëri është figurë por edhe tjetri është figurë, prandaj ne si delegatë e kemi pak të vështirë që të vendosim, kolegu z. Refki Kryeziu sipas tij prezantoi qëndrimin e banorëve të fshatit Xërxe i cili dallon pak nga ai që ne e kemi diskutuar në KPF, pra e kanë një propozim të vetin, por ne e kemi kaluar propozimin në KPF që të diskutohet në kuvend, kurse vendimi do të merret sot, por nuk e di a do të mundemi ne sot me vendos rrëth këtij propozimi, kurse për emrat e tjerë nuk me vërejtje. Sa i përket propozimeve për qytet si të Mizahir Ismes dhe Jahja Danuzes, këto emra janë përmendur edhe më herët nëpër qytet, dhe ka pasur një mendim shumë pozitiv për këto emra. Kisha dashur që ne sot të i japim një zgjidhje sa më të mirë kësaj pike, por nëse vjen në pikëpyetje vetëm një institucion atëherë ne mundemi me i kalue pesë propozimet e tjera, kurse për emërtimin e gjashtë për fshatin Xërxe mundet të debatohet pak më gjerë dhe në njérën nga mbledhjet e ardhme të votohet edhe ky propozim.

Afërdita Thaqi – Do të i drejtohem kryetarit të shoqatës të dala nga lufta e UÇK-së z. Vajdin Berisha, i pash disa propozime për emërtim të disa institucioneve, por propozimi imë kishte me qenë që secili fshat të i emëroj institucionet me emra të njerëzve të tyre, unë jam vajza e dëshmorit dhe publikisht po ja them z. Vajdin Berishës se a nuk e ka merituar që të jetë emri i babait tim këtu në këtë listë, a nuk ka qenë ai luftëtar, a nuk ju ka mjaftuar që ka fakte se jo vetëm që ka qenë pjesë e luftës e UÇK-së por sot në bazë të ballafaqimit të babait tim në kufi me forcat serbe janë gjallë rrëth 100 ushtar, ai është vrarë që të i shpëtoj jetën këtij grapi të ushtarëve, kurse sot unë nuk e shoh emrin e babait tim në këtë listë, është shumë marri nga ana e z. Vajdin Berishës që nuk e shohë emrin e babit tim në këtë listë. I kanë faktet edhe ky edhe z. Feriz Thaqi që babai imë është vrarë në kufi sepse i ka thënë ushtarëve ju shkon se jeni të ri kurse unë do të ballafaqohem me ushtar serb, dhe si janë larguar ata është ndier krisma nga e cila është vrarë babai imë. Po ashtu pajtohem me propozimin e z. Refki Kryeziut, më vije keq që është ushtar emri i propozuar por nëse nuk të donë komuniteti nuk ke çka të bësh, ata janë ata që vendosin se cili emër duhet të vendoset në institucionet që i përkasin fshatit të tyre.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e nderuara z. Afërdita do i vije rendi edhe babait tuaj sepse do të ndërtohet edhe qendra e kulturës në Çifllak e di që e meriton babai juaj, por këto propozime

që janë dhënë janë propozime me vend dhe mendoj se nuk është e nevojshme që të diskutohet më shumë. Sa i përket propozimit të fshatit Xërxe, mendoj se kishte me qenë mirë që të i kalojmë pesë propozimet e para, kurse propozimin e fundit ta lëmë në një mbledhje të tjetër, me kusht që të bisedohet edhe një herë dhe të gjendet një pikë e përbashkët dhe të koordinohen gjërat siç është më së miri.

Rasim Fazliu – Ne këtë pikë e kemi trajtuar në KPF dhe duhet të jemi të qartë ne kemi qenë unanim të gjithë që këto emra janë të qëlluar pa dashtë me anashkalu asnjë dëshmorë sepse dëshmorët janë të gjithë sepse ata e kanë dëshmuar me gjakun e tyre. Por ne duhet të dimë se kemi një institucion, organizatat e dala nga lufta, dhe më mirë se ata që i njohin gjërat ne të tjerë nuk mundemi të i njohim, ata kanë dalë me një propozim konkret, siç e tha kolegu imë z. Sali Sallteku të gjithëve do i vije radha sepse ne do të vazhdojmë ende me ndërtim të objekteve të reja dhe besoj se do i nderojmë të gjithë, por menjëherë nuk mundemi të gjithë, duhet të shkojmë gradualisht. Të nderuar ne në mbledhje të KPF-së nuk e kemi pasur këtë situata që e kemi tani nga këshilli i fshatit Xërxe, për atë ne kemi qenë dakord me këto emra të propozuar, pa dashtë me abstrahu që edhe të gjithë dëshmorët e tjera që nuk janë këtu do ta kishin vendin këtu por ne nuk mundemi që pesë emra të ja vendosim një objekti, por besoj se edhe atyre do i vije radha. Propozoj që të bëjmë një pauzë të vogël që të konsultohemi dhe pastaj do të vendosim se çka do të bëjmë më tutje rrëth kësaj pike. Por duhet të dini se tani diksutimi është duke u bërë vetëm rrëth propozimit të fshatit Xërxe, kurse me propozimet e tjera jemi në rregull të gjithë i mbështesim.

Ali Zhuniqi – Ne si VV e kemi parë shumë të rëndësishme emërimin e këtyre institacioneve, padyshim që jemi të pajtimit me të gjitha emrat që janë ardhur nga shoqatat e dala nga lufta, dhe e vlerësojmë në mënyrë të veçantë secilin nga personalitetet që kanë dhënë kontribute për këtë ditë. Sa i përket emrit të fundit është në rregull që kolegu z. Refki e ka shprehur si shqetësim, por i nderuari është dashur së paku të na sjellë neve në kuvend disa nënshkrime nga këshilli i fshatit Xërxe që janë të pajtimit me emrin e propozuar nga z. Refki Kryeziu. Mendoj se nuk krahasohet emri i një dëshmori i cili ka dhënë kontribute në dy luftëra që të zëvendësoshet me një emër të një violinisti i cili ka pasur violinën profesion.

Kryesuesi – Të nderuar pasi është koha e pauzës po dalim dhe pas një ore e vazhdojmë mbledhjen, ju faleminderit.

Rasim Fazliu – Për shkak të ndjeshmërisë që e ka kjo pikë e rendit të ditës, propozoj në emër të grupit të PDK-së që pesë emrat e parë që janë në këtë listë të votohen sot, kurse për emrin e gjashtë që na ka ardhur edhe një propozim i ri nga banorët e fshatit Xërxe të shtyjmë për një mbledhje të radhës.

Kryesuesi – E qes në aprovim propozuesin e z. Rasim Fazliu, që pika e gjashtë të votohet me një mbledhje tjetër: Konstatoj se me shumicë votash është aprovuar propozimi i shefit të grupit të PDK-së z. Rasim Fazliu. Tani e qes në votim Kërkësën e Shoqatave të dala nga lufta të UÇK-së, për emërtimin e disa institacioneve komunale me emrat e dëshmorëve të kombit, duke përashtuar propozimin për fshatin Xërxe: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë(6) e rendit të ditës: kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për dhënien e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

Afrim Oruç – Para jush e keni materialin dhe propozimin e kryetarit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër pronën publike në afat prej 1-15 vite, këtu kemi të bëjmë me zonën kadastrale në Hoçë të Vogël, kjo pronë është pronë shtetërore, vendi i quajtur Kalish, kjo parcelë kadastrale sipas certifikatës së pronësisë është kullosë e klasit të gjashtë me sipërfaqe prej 10 arri 37 m² qëllimi i dhënes së kësaj prone në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike, dhe për i dhënë mundësi qytetarëve për të kultivuar bujqësinë dhe për vetëpunësim. Propozim vendimi është për afat prej 15 vite, prona e paluajtshme në fjalë nuk do e nderon titullin, pastaj do të nënshkruhet një kontratë me komunën e Rahovecit, çmimi do të përcaktohet sipas ofertuesve se kush jepe më shumë, po ashtu ky ligje nuk do të përcaktohet nga Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Ftojë kuvendarët që ta përkrahin këtë propozim vendim të kryetarit.

Rasim Fazliu – Ne jemi pro këtij propozimi vendimi, qëllimi këtu është cekur për ruajtje dhe rritje të vlerës publike, është cekur edhe destinimi i veprimitarise për kultivim të bujqësisë. Propozimi imë është që të jepet për 10 vite.

Fehmi Cena – Po ashtu edhe ne jemi pro këtij propozim vendimi për dhënien e kësaj parcele, duke parë që qëllimi dhe destinimi është i mirë. Sa i përket afatit kohorë 10 apo 15 vite, besoj se kjo do të rregullohet në ankand nuk është ndonjë problem i madh, me rëndësi është që ai biznes i cili do ë zhvillohet aty të ecë mbarë. Kisha me pas një kërkesë për Drejtorin për Gjeodezi, kadastër dhe pronë, kur të i përgatisin këto skica që na sillen neve, kishte me qenë mirë që përpos sipërfaqes së parcelave të ketë skica edhe ndonjë shenjë plotësuese, p.sh ndonjë rrugë afër se ndonjë ndërtesë, në mënyrë që ne të kemi një orientim më të quartë se për cilën parcelë bëhet fjalë.

Florije Boshnjaku – Sa i përket këtij propozim vendimi edhe unë pajtohem që të kalojë në kuvend, i nderauri z. Rasim Fazliu propozoi që afati të jetë prej 10 viteve, por ne deri më tani gjithmonë e kemi praktikuar 15 vite, por edhe 10 vite me qenë nuk është kohë e shkurtër që ti jepet dikujt në shfrytëzim.

Kryesuesi – I nderauri z. Rasim Fazliu ka pasur një propozim që afati kohorë për dhënie në shfrytëzim të jetë 10 vite, e qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që afati kohorë të jetë për 10 vite: Konstatoj se me shumicë votash është aprovuar votimi i z. Rasim Fazliu. E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit për dhënen e pronës së paluajtshme komunale P – 71510008-00331-0, në shfrytëzim personave fizik dhe juridik deri në 10 (dhjetë) vite: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i raportit mbi gjendjen e stacionit të autobusëve në komunën e Rahovecit.

Nënkyetari – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, pasi drejtori i Shërbimeve Publike nuk është prezent, pasi i ka shkuar në Prishtinë siç e tha edhe ai vetë për një punë zyrtare, po ju prezantoj unë këtë raport. Nëse doni unë mundem të ju lexoj raportin por ju para vete e keni, por siç po shihet sipas këtij rapporti gjendja e stacionit të autobusëve nuk është në gjendje të mirë. Po ju përmendi një fakte në mënyrë që ne të ecim më tutje në këtë aspekt, ky stacion duhet të bartet në pronë të komunës, besoj se këto procedura kanë filluar dhe nëse jo mendoj se duhet të fillojnë në mënyrë që të kryhet ai transaksioni juridik. Duke marr për bazë gjendjen jo shumë të mirë pothuajse hiq të mirë, komisioni i aksionareve duhet që të shpallë konkurs ku duhet që të zgjidhen katër drejtorë, pastaj këta katër drejtorë shpallin përsëri konkurs ku e zgjedhin kryeshefin ekzekutiv, pra këto janë procedurat të cilat duhet të kalojnë. Besoj se janë procedurat të cilat duhet me u ndjekë, këtu i kemi edhe dy kuvendarë që janë anëtar të këtij komisioni, ata janë z. Rexhep Oruçi dhe znj. Hanalora Hoti, me gjasë këta katër drejtorë në fillim do të kenë një pagë minimale.

Rexhep Oruçi – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, po flasë si kuvendar dhe si anëtar i komisionit, iniciativa për reformimin e stacionit të autobusëve në Rahovec është dhënë për shkaqe logjike dhe shumë të arsyeshme, duke e ditur pak a shumë se kjo gjendje është shumë e keqe dhe nuk ka menaxhim të mirëfilltë, aty nuk ka evidencia as të hyrjeve as të daljeve nga ndërmarrja dhe me veprimit të mëtutjeshëm të stafit frikohem se do të na vije dita që ne si komunë dhe si qytet mos të kemi këtë stacion të autobusëve fare. Arsyja pse po e them këtë është se llogaria rrjedhëse e kësaj ndërmarrje është mbyllur qysh herët dhe krejt çka është punuar dhe vazhdon të punohet është në të zezën, pagat e punëtorëve janë shumë të vogla dhe ajo çka i paguhet i paguhet pa kurrfarë tatimi ose pagës të kontributive. Aty nuk ka rrymë, nuk ka nyje sanitare e shumë gjëra tjera, nuk e di në shekullin 21 të lejojmë ne si komunë që të vazhdohet kjo agoni më duket se do të jetë shumë mare për këtë kuvend dhe për ekzekutivin. Pse nuk është bërë një auditim i brendshëm. Është dashur të bëhet një auditim i brendshëm sepse qe pesë muaj është formuar ky komision, ne e kemi në komunë zyrën e auditimit dhe është mirë të autorizohet kjo zyre për ta bërë një auditim të këtij stacioni. Pasi të kemi gjendjen reale të këtij institucionit atëherë do të shohim se çka mundemi të bëjmë, i nderauri z. Përparim Krasniqi ka ecur sa ka mundur vetë, ne si komision nuk kemi ecur ashtu siç është dashur, mendoj se është dashur të ecë rrjedha pakë më ndryshe, të kemi një raport të autditimit, pastaj të shikohet gjendja financiare e këtij stacioni, sepse mënojmë se diku rreth 104,000.00 € është borxhi i kësaj ndërmarrje, dhe

dikush nga kreditorët mundet në çdo moment me e shpallë ankandin publik, dhe me këtë ndërmarrja shkon në likuidim, pastaj mundet të blejë këtë ndërmarrje ndonjë matrapaz dhe stacionin të shndërroje në ndonjë depo, sepse nuk e obligon ligji që kur ta privatizoj ky ta mbajë si stacion të autobusëve, ai mundet të ja nderoj destinimin. Të nderuar ky stacion është në mes të qendrës i ka më shumë 30 ari vend, vlera e këtij stacioni është më shumë se 1 milion, dhe ky aset të i lihet lloj lloj njeriu që të menaxhoj, kurse komuna nuk është në gjendje që të merë një vendim që këtë pronë ta bartë në menaxhimin e saj, pasi të përfundoj e gjitha kjo atëherë ne mundemi të mëremi me procedurat e tjera. Propozoj që në mbledhje të radhës ju si kryesues i kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës dhe ne si grup punues, ta autorizojmë auditorin që ta bëjë auditimin e këtij stacioni, dhe të na sillet neve një raporte, pastaj zyra ligjore të na sjellë një informatë zyrtare se si duhet të ndiqet procedura ligjore për bartje të këtij stacioni të autobusëve në menaxhim të komunës.

Fehmi Cena – Mendoj se ky raport është mjaf i qartë, i ka të përbledhura të gjitha elementet më kryesore, po ashtu e ka destinimin se për çka e kemi formuar ne këtë komision në nivel kuvendi. U dhanë disa sqarime të cilat janë dhënë nga nënkyetari dhe anëtari i këtij komisioni z. Rexhap Oruçi, reporti i ka përbledhur gjendjen aktuale, siç po shihet gjendja e këtij stacioni qenka mjafë e koklavitur dhe e vështirë. Nuk e kam të qartë diçka në këtë raport sepse është cekur në fillim se të hyrat e këtij stacioni për një muaj janë 3,179.00 €, pastaj më poshtë ceket edhe qiraja nga restoranti 320.00 €, pyetja ime është: Kjo shumë e qirasë nga restoranti a bënë pjesë në këtë shumë apo është plus, nëse është ndaras atëherë mendoj se është dashur në fund të mblidhet kjo shumë dhe të ceket se të hyrat mujore janë 3,499.00 €. Por sidoqoftë borxhi prej 100,000.00 € e rëndon situatën edhe më shumë, por ne jemi pro që kjo procedurë të vazhdoj dhe komisioni të qojë punën e vetë deri në fund, në mënyrë që kjo kompani të mos vazhdoj të punoj kështu siç ka punuar deri më tani plotësisht në mënyrë të zezë siç e tha z. Rexhep Oruçi, por të mirët në mënyrë ligjore dhe të menaxhohet nga ana e komunës.

Sali Sallteku – Pajtohem plotësisht me parafolësit, por kërkoi që në mbledhjen e radhës të bëhet një sqarim nga zyra ligjore dhe të i shpërndahet kuvendarëve, të në sqaroj neve në mënyrë të sqaruar se cilat janë procedurat e mëtutjeshme. Kjo temë është tej zgjatur edhe qeverisja e kaluar është mare me këtë temë, është mirë që kjo punë të përfundoj dhe mos të mëremi ne më me këtë punë. Sa ma shpejtë që ta përfundojmë këtë punë aq më mirë sepse me të vërtet njeriu nuk po mundet të kalojë nga stacioni nga era, është mirë që të përfundojmë këtë punë sa ma shpejtë sepse është një pamje e keqe për ne, në mes të Rahovecit të kemi një gjendje të tillë.

Qazim Qeska - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky raport është mjaf i qartë, vota ime është pro por të ju them të drejtën pak jam në mugull, prandaj do të doja nga qeverisja lokale të më tregoj se cili është statusi i këtij stacioni, e kemi ligjin për ndërmarrje publike i cili në faqe të fundit cekë se stacioni i autobusëve është 100% aset i komunës së Rahovecit. Nëse është ashtu atëherë të gjitha këto pika tjera që janë cekur në raporte janë të lehta, sa e di unë stacioni i autobusëve nuk është ndërmarrje shoqërore dhe agjensioni Kosovar i privatizimit nuk ka se çka të bëjë aty, ai nuk ka kurrfarë kompetenca mbi këtë stacion, sikurse të kishte pasur deri më tani kishte me e privatizuar sikurse që na i ka privatizuar kooperativat më të vogla bujqësore. Komisioni aktual ka bërë punë të mira, por kisha kërkuar nga ky komision që të implementoj vetëm ligjin për shoqëritë tregtare i cili është aktualisht në fuqi dhe këtë ndërmarrje ta bëjmë ndërmarrje lokale me 100% aksionare komunën e Rahovecit.

Rexhep Oruçi – Ligji mbi shoqërinë tregtare e ka rregulluar punën ne stacioneve të autobusëve shumë mirë, stacionet e autobusëve i kalojnë me kompetencë të plotë 100% komunave, kështu që ne e kemi të zgjidhur problemi ligjor vetëm a jemi ne ata që dëshirojmë të ecim përpara dhe të kryejmë punë.

Florije Boshnjaku – Plotësisht pajtohem që kjo çështje është qe 20 vite, prandaj mendoj se do ta kemi pakës problem deri sa të vijmë tek zgjidhja përfundimtare e këtij problemi, edhe atëherë kam qenë por edhe sot jam që njerëzit të cilët minden të japid kontribut të i bashkëngjiten dhe të i ndihmojnë këtij komisioni, mos të lidhemi vetëm me atë se a do të marrim ndonjë mëditje apo jo, e gjithë kjo është duke u bërë për të

mirën e qytetarëve të komunës së Rahovecit, siç u tha të shkoj në likuidim për arsyen e 104,000.00 € besoni se për ne është një far obligimi ndaj qytetarëve, pse të jepet dikujt që ta privatizoj kur ne mundemi me qenë vetë aksionarë në këtë stacion. Sa i përket asaj që e tha z. Qeska unë sa e di janë ndërmarrja shoqërore dhe ndërmarrja publike, OLTI ka qenë ndërmarrje shoqërore, prandaj AKP-ja të gjitha ndërmarrjet shoqërore i ka dërguar në privatizim.

Nënkyetari – Shumë mirë që janë duke u bërë këto kritika sepse të gjitha janë duke u bërë në nivel diskutimi, por duhet të dini se kjo punë është duke u diskutuar qe pesë vite, asnjë iniciativë nuk është mare në mandatin e kaluar, e kam ngritur vetë personalisht kur kam qenë kuvendarë 3-4 herë si çështje, tani në këtë vite ne e kemi formuar një komision të aksionareve dhe ky komision duhet që ti kryej detyrat e veta sepse për atë është themeluar, nuk është mirë që të gjuhen punët e tyre dikujt tjetër, përderisa vetë ju si anëtar të komisionit duhet që ti merrni dhe të i kryeni punët që ju takojnë juve. Ju si komision sillni rekomandimet kryetarit të komunës dhe kuvendit komunal, po ashtu e keni edhe zyrën ligjore në disponimin tuaj për çdo gjë që mendoni se e keni të paqartë, por ky komision është formuar nga ky kuvend me një detyrrë të caktuar, që ju të i kryeni punët deri në stadin ku duhet dhe me një rekomandim për kryetarin e komunës se çka më tutje, kurse sa i përket punës së audititmit dhe statutit këto janë të gjitha çështje teknike.

Rexhep Oruçi – Kryesues ne është fakt se jemi të formuar nga kuvendi si komision, por komisioni jepe ide dhe propozime, por unë nuk mundem të iu them kryesuesit të kuvendit se i na duhet një vendim nga kuvendi për bartje të këtij stacioni, pra ky kuvend duhet të merë një vendim, prandaj po e them se është mirë edhe ju si ekzekutiv edhe ne si kuvend të bëhem bashkë dhe të kryejmë këtë punë.

Kryesuesi - Të nderuar kuvendar ju faleminderit për kontributin e dhënë në mbledhjen e sodit, me kaq përfundon mbledhja mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 14:45

01 Nr. 3375

Rahovec, 28.12.2018

Procesmbajtësi
Skender Hamza



K R Y E S U E S I
Affrim Dina